Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/564
Datë: 05.08.2025

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2025 merr:

V E N D I M

I. **Akreditohet, "SPEEEX Education"**, me tre qendra, me adresë: Prishtinë në adresën Rr. Tirana, 10000, Vushtrri në adresën Rr. Deshmoret e Kombit", 42000, Ferizaj, në adresën, Rr. Driton Islami, 70000, për periudhën tre (3) vjeçare, (01.08.2025 – 31.07.2028), për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar këto kualifikime:

1. KURSE TË GJUHËS GJERMANE NIVELI A1 – C1

1.1. Qendra Prishtinë, ka katër mësimdhënës të gjuhës gjermane të angazhuar, dy (2) mësimdhënës x 20 grupe x 16 nxënës për grup 640 nxënës. Dy (2) mësimdhënës x 10 grupe x 16 nxënës për grup 320. Brenda një viti gjithsej: 960 nxënës.

1.2. Nënqendra Vushtrri, ka dy mësimdhënës të gjuhës gjermane të angazhuar, dy (2) mësimdhënës x 20 grupe x 16 nxënës për grup 640 nxënës..

1.3. Nënqendra Ferizaj, ka dy mësimdhënës të gjuhës gjermane të angazhuar, dy (2) mësimdhënës x 20 grupe x 16 nxënës për grup 640 nxënës. Brenda një viti gjithsej: 640 nxënës.

2. KURSE TË GJUHËS FRËNGE NIVELI A1 – C1

2.1. **Qendra Prishtinë,** ka një mësimdhënës të gjuhës frënge të angazhuar. 1 mësimdhënës x 20 grupe x 16 nxënës për grup 320 nxënës. Brenda një viti gjithsej: 320 nxënës.

2.2. **Nënqendra Vushtrri,** ka një mësimdhënës të gjuhës frënge të angazhuar. 1 mësimdhënës x 20 grupe x 16 nxënës për grup 320 nxënës. Brenda një viti gjithsej: 320 nxënës.

2.3. **Nënqendra Ferizaj**, ka një mësimdhënës të gjuhës frënge të angazhuar. 1 mësimdhënës x 20 grupe x 16 nxënës për grup 320 nxënës. Brenda një viti gjithsej: 320 nxënës.

II. **Akreditohet dhe Validohet, "Speex Education"**, me tre qendra me adresë: Prishtinë në adresën Rr. Tirana, 10000, Vushtrri në adresën Rr. Deshmoret e Kombit", 42000, Ferizaj, në adresën, Rr. Driton Islami, 70000, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data: (01.08.2025 – 31.07.2028), me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

1. **"SHITJA DHE KUJDESI NDAJ KLIENTIT"**, niveli i IV-KKK. Lloji i kualifikimit: **Kualifikime Kombëtare Profesionale (D),** 10 kredi të AAP. SPEEEX Education SH.P.K. në Prishtinë, Ferizaj dhe Vushtrri, si dhe në numrin dhe shpërndarjen e trajnerëve të angazhuar sipas lokacioneve përkatëse, institucioni ka kapacitet të organizojë deri në katër (4) cikle trajnimesh gjatë një viti kalendarik, në mënyrë paralele, me nga dy grupe mësimore për çdo cikël.

1.1. Qendra Prishtinë, gjatë një cikli trajnimi, mund të regjistrohen deri në 27 kandidatë (15 kandidatë në një sallë dhe 12 kandidatë në sallën tjetër). Kapaciteti maksimal vjetor i pranimit të kandidatëve është 108 kandidatë (4 cikle x 27 kandidatë).

1.2. Qendra Vushtrri, gjatë një cikli trajnimi, mund të regjistrohen deri në 29 kandidatë (15 kandidatë në një sallë dhe 14 kandidatë në sallën tjetër). Kapaciteti maksimal vjetor i pranimit të kandidatëve është 116 kandidatë (4 cikle x 29 kandidatë).

1.3. Qendra Ferizaj, gjatë një cikli trajnimi, mund të regjistrohen deri në 24 kandidatë (12 kandidatë në secilën nga dy sallat e përdorura). Kapaciteti maksimal vjetor i pranimit të kandidatëve është 96 kandidatë (4 cikle x 24 kandidatë).

III. Obligohet Institucioni të plotësojë kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues dhe kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

IV. Institucioni mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së "**SPEEEX Education**", të parashtruar në AKK, për akreditim dhe validim të institucionit në Prishtinë, Vushtrri dhe Ferizaj, për kualifikimin: TIK me Elektronikë, Niveli III dhe IV i KKK, bazuar në kualifikimet kombëtare të kombinuara si dhe kualifikimet e bazuara në standarde ndërkombëtare.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit për kualifikimet:

1. **KURSE TË GJUHËS GJERMANE NIVELI A1 - C1**;
2. **KURSE TË GJUHËS FRËNGE NIVELI A1 – C1** dhe
3. **SHITJA DHE KUJDESI NDAJ KLIENTIT"**, niveli i IV-KKK, 10 kredi të AAP, Niveli III dhe IV ka realizuar vizita me datën 30.05.2025.

Pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë 18.06.2025. Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 25.07.2025.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushëveprimtaria e AKK-së ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për akreditim dhe validim për kualifikimet si më lartë.

Këshilli Drejtues i AKK-së bazuar në nenin 50 të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa pjesët tjera të dispozitivit dhe arsyetimit të Vendimit Nr.01/553, i datës 07.09.2022 të Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të kualifikimeve, mbeten të njëjta.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Dr. Besim Mustafa
Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit, "SPEEEX Education" dhe,
2. Arkivit të AKK-së.